



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202101316/2

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisaratin e Policisë në Kuçovë.*

Drejtuar: **Z. Erjon ISMAILI**
Shef i Komisarimit të Policisë

KUCOVË

Për djeni: **Z. Edmond TARKAJ**
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

BERAT

I Nderuar Z. Ismaili,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenin 81 i ligjit nr.81/2020 datë 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë në Kuçovë.

Inspektimi u krye në datën 15.10.2021, sipas një plani inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita, dhe z. Besnik Deda, nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, "Për miratimin e procedurës standarde, "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së Shtetit", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrorë konkluzionet përfundimtare, të parashtruara në vijim:

Shënime të përgjithëshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë z. Geront Seitllari dhe shefin e rendit z. Kastriot Stafhasni, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Pasi u njohën me qëllimin e inspektimit, shefat e komisarariatit dhe ai i rendit informuan grupin e inspektimit në lidhje me kushtet në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit, angazhimin e punonjësve të policisë së këtij komisaritati për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente.

Gjithashtu, shefi i komisarariatit, angazhoi shefin e rendit dhe përgjegjësën e ambienteve të shoqërimit të këtij institucioni që të ishin prezent për të bashkëpunuar dhe për të shërbyer në vijim të procesit të inspektimit. Grupi inspektues, pasi mori informacionin e përgjithshëm të nevojshëm, vijoi takimin me punonjësën përgjegjëse të dhomave të shoqërimit që na u bashkua gjatë evidentimit të kushteve të këtyre ambienteve të Komisarariatit të Policisë Kuçovë.

U inspektuan ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u verifikuar dokumentacionin përkatës që pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar të arrestuar apo të ndaluar.

Theksojmë se, punonjësit e Komisarariatit të Policisë Kuçovë me të cilët kontaktua u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit.

Në Komisariatin e Policisë Kuçovë, nga informacioni i grumbulluar gjatë kryerjes së inspektimit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2019, rezultoi se: ¹

1. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për ndërtimin dhe vënien në funksionim të ambienteve të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Kuçovë sipas kritereve të parashikuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurën standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke pasur edhe një dhomë tjetër të tretë më vehte për të shoqëruarit e mitur, i cili duhet të jetë një mjedis i përshtatshëm dhe dinjitoz, i pajisur me orëditë e nevojshme për qëndrimin e kësaj kategorie personash.
2. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e dhomave (zyrave) të punës në këtë komisaritat ku merren në pyetje apo intervistohen personat e ndaluar/arrestuar dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.
3. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin e ambientit të shoqërimit të këtij komisaritati.

¹ Dërguar rekomandimi për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Kuçovë nr. K4/I 81-2 prot, datë 19.02.2020

Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, në ambientet aktuale në Komisarriatin e Policisë Kuçovë, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisarriatin e Policisë të Kuçovë, **dhomat e shoqërimit nuk ishin** të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.²

Komisariati i Policisë të Kuçovës, brenda mjediseve të tij, kishte dy dhoma shoqërimi funksionale të ndara një për të rritur, dhe tjetra për femra dhe të mitur. Dhomat e shoqërimit ishte me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, e pajisur me tavolina dhe stola për të mundësuar qëndrimin ulur të personave. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4x5m me kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur për secilën deri në 4 persona.

Dhoma e shoqërimit kishte dritare përmasat e së cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Dhomat gjithashtu, kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Dera ishte prej druri, me mundësi për t’u mbyllur nga jashtë. Në përgjithësi dhoma ishte e pastër, nga ana higjieno-sanitare. Dhomat e shoqërimit nuk kishin sistem ngrohjeje/ftohje.

Mungesa e dhomës të shoqërimit për të mitur në konflikt me ligjin, siç është parashikuar në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, tregon mos garantimin e lirive të të drejtave të njeriut, sipas standardeve që kanë të bëjnë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë.

Në fund të korridorit të dhomave të shoqërimit ndodhej 1 (një) tualet, me ujë të rrjedhshëm në 24 orë dhe e pajisur me të gjitha mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, por mungon tualeti për gratë në ambientet e këtij komisarriati, duke mos u trajtuar sipas standardeve të përcaktuara në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019. “Për miratimin e procedurës standard”, “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së Shtetit”.³

Nga inspektimi i ambienteve të dhomave të shoqërimit, u konstatua se gjendja teknike e godinës ishte e amortizuar dhe kishte nevojë për ndërhyrje të menjëhershme për rikonstruksionin e saj. Dhomat dhe ambientet në Komisarriatin e Policisë Kuçovë edhe pse ishin të lyera, në vende të caktuara, kishte rënë suvaja për shkak të lagështirës që ishte prezente kudo. Ky shqetësim, u evidentua edhe nga drejtuesit e komisarriatit, **lagështira ishte evidente në gjithë godinën e komisarriatit, por më e theksuar ishte në ambientin e tualeteve.** Niveli i lagështirës ishte tej normave të pranushme, e ka ndikim negativ në

² “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

³ ³ Kreu VII pika 4 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”. Ku përcakton se brenda këtyre ambienteve ose ngjitur me to, të ketë tualete, të ndara për femra dhe meshkuj, të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim.

jetën dhe shëndetin e personave të shoqëruar, ndaluar/arrrestuar, si dhe për vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Në këtë komisariat nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të të gjitha ambienteve të këtij institucioni. Mbikqyrja me kamera e të gjitha mjediseve të komisariatit Kuçovë, përveç atyre mjediseve ku çënohet privatësia, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Së dyti, mbikqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisariatit, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet përkatëse që hartojnë institucionet monitoruese të pavarura.

Në Komisaratin e Policisë Kuçovë, gjatë periudhës 01.01.2021 deri më 15.10.2021 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evindetuar në regjistrin e shoqërimit **172** persona, ku saktësisht **170** shtetas madhor, dhe **2** shtetase femera të shoqëruar në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112/1 të ligjit për Policinë e Shtetit. Në momentin e inspektimit **nuk kishte asnjë shtetas** në dhomat e shoqërimit.

Gjithashtu, na u bë me dije se personat e shoqëruar nga policia informoheshin për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. **Avokati i Popullit kërkon dhënien e kopjes së kartës së të drejtave** në momentin e hyrjes në komisariat, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat e tyre.

Nga verifikimi i regjistrit të marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin 2021 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

Gjatë inspektimit nuk u konstatua asnjë rast, apo u administrua ndonjë ankesë lidhur me ushtrim dhune apo trajtim degradues. Gjatë inspektimit u kqyrën të gjitha zyrat e oficerëve të Policisë Gjyqësore në të gjitha ambientet e komisariatit. Në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/merren në pyetje.

Marrja në pyetje dhe intervistimi i personave të shoqëruar, në mungesë të një ambienti më vete, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Dhomat e shoqërimit dhe zyrat e punës të punonjësve të policisë, nuk monitoroheshin nga sistemi i kamerave.

Më tej u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të komisariatit, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Kuçovë nuk kishte ambiente të sigurisë. Personat e arrestuar/ndaluar, pasi përfundonin veprimet procedurale nga punonjësit e policisë, dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarlatin të Policisë Berat.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Komisarlatin e Policisë të Kuçovë, u konstatua se “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”, ishte i tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁴.

Në këtë komisarlat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e arrestimeve dhe ndalimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë, nisur nga momenti, çasti, kur privoheshin nga liria.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarlat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën që u krye inspektimi, nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë.

Gjithashtu në Komisarlatin e Policisë Kuçovë kishte edhe regjistër për takimet me avokatin ose prokurorin, regjistër të marrjes në pyetje dhe informacion në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja për të drejtat e personave të ndaluar ose të arrestuar.

Nga inspektimi, u konstatua se komisarlati i Policisë Kuçovë, ishte pajisur me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin. Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë vitit 2021 nuk kishte të shoqëruar të mitur në konflikt me ligjin. Ky regjistër ishte hapur në zbatim të rekomandimit të Avokatit të Popullit, për marrjen e masave, për pajisjen e komisarlateve të policisë me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin.⁵

⁴ *Kreu VII, Procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.*

⁵ Detyrim i përcaktuar nga ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Ambientet e intervistimit

Në Komisarjatin e Policisë së Kuçovës, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara me kamera, për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse u përshkrua edhe më sipër, ky rekomandim nuk është zbatuar ende.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare⁶, por edhe kombëtare e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Komisariati i Policisë Kuçovë në kushtet aktuale nuk posedonte hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me persona të mitur. MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve.

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë në godinën aktuale të Komisarjatisë së Policisë Kuçovë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokuroris, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të zyrës së informacionit.

⁶ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Ndërsa psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat, por dhe në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Kuçovë ishte zhvilluar konform ligjit.

Në raste kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë në qendrën shëndetësore Kuçovë, për të marrë ndihmën mjekësore.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut i cili sigurohej në kohë përmes ndihmës nga shkolla e mesme e këtij qyteti ose nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat dhe qëndronte i pranishëm derisa përfundonte procedura përkatëse.

Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Edhe në nenet 34/b. pika 2 dhe 251 të K.Pr. Penale parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar: “*Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit*”.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit si dhe në dhomën e shoqërimit të këtij Komisaritati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës, si dhe në dhomën që përdorej për shoqërim të këtij komisaritati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Për shkak së situatës të krijuar nga përhapja e sëmundjes infektive COVID-19, grupi i inspektimit kontrollloi gjithashtu, se çfarë masash ishin marrë për parandalimin e kësaj pandemie, sigurimin e maskave mbrojtëse dhe disinfektantëve për stafin. Konkretisht rezultoi se nuk ishin zbatuar kryesisht rregulli në mbajtjen e maskës në ambientet e punës, disinfektantë për pastrimin e duarve nuk ishin vendosur në vende të dukshme në ambientet e shoqërimit, nuk ishin afishuar materiale informuese për zbatimin e protokollit shëndetësor për parandalimin e kësaj sëmundje, për ruajtjen e distancës fizike mes njëritjetrit, me qytetarët, etj.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese, në korridorin e institucionit ashtu në ambientin e dhomës të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Kuçovë.
2. Marrjen e masave të nevojshme dhe gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisaritit të Policisë Kuçovë me qëllim kthimin e tij në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjtoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për të garantuar kushte të përshtatëshme pune për punonjësit e policisë së këtij institucioni.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e lagështirës në ambientin e dhomave të shoqërimit si dhe në korridoret të Komisaritit të Policisë Kuçovë.
4. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Kuçovë, sipas kritereve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke përfshirë në të dhe ndërtimin e një dhome shoqërimi për të miturit në konflikt me ligjin.
5. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave në Komisariatin e Policisë Kuçovë ku merren në pyetje personat e shoqëruar, të ndaluar/arrestuar dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente.
6. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
7. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e një tualeti të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisaritit të Policisë Kuçovë, për shtetaset femra të shoqëruar ndaluar/arrestuar në konflikt me ligjin.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e paisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

ERMONELA XHAFA